REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

EMERGJENCA CIVILE

KRYETARI

Miftar DAUTI

Nr. 1523/4 Prot.

Krumë më 08 / 05 2025

PLAN - GADISHMËRIE

PËR
EMERGJENCAT CIVILE TË SHKAKTUARA NGA SITUATAT GJATË PERIUDHËS SË VERËS NË RRETHIN HAS

QËLLIMI I PLANIT TË GADISHMËRISË

- Marrja e masave paraprake për përballimin e situatave emergjente në periudhën e verës si pasojë e temperaturave të larta, në rajonin e Rrethit te Hasit.

OBJEKTIVI I PLANIT TË GADISHMËRISË

- Përpilimi i Planit të Përgatitjes, për fatkeqësitë që mund të ndodhin si rezultat i temperaturave të larta dhe rolin e strukturave të ndryshme shtetërore për zbatimin e tij.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

- Ndërhyrjen e menjëhershme për plotësimin e nevojave emergjente.
- Rritjen e kapaciteteve në rastin e fatkeqësive.
- Rritjen e sensibilizimit publik lidhur me përgatitjen ndaj fatkeqësive.

DREJTIMET KU DO TË VEPROHET PËR REALIZIMIN E PLANIT TË GADISHMËRISË

- Përditësimin e strukturave të menaxhimit të situatave.
- Sistemin e informacionit.
- Vlerësimin e dëmeve.
- Kordinimin me strukturat qeveritare e joqeveritare.
- Ndërhyrjen në familje apo grup familjesh më në emergjencë.

I.SHTRIRJA DHE NDIKIMI I DUKURIVE TË MUNDSHME NË RRETHIN E HASIT

Rrethi i Hasit shtrihet në pjesën Verilindore të Republikës së Shqipërise. Ka një siperfaqe prej 399.62 km katrore e popullsi 21 851 banorë.

Rrethi përbëhet nga 1 Bashki (Has) dhe 4 Njësi Administrative (Krumë, Golaj, Gjinaj dhe Fajza).

- **SIPËRFAQJA E BASHKISË**

Nr	BASHKIA	Sipërfaqe	Nj Matëse km 2
1	Has	399.62	km2

- **POPULLSIA E BASHKISË**

Nr	BASHKIA	POPULLSIA	
1	Has	21 851	banorë

- **NUMRI I FAMILJEVE TE BASHKISË**

Nr	BASHKIA	NUMRI I FAMILJEVE
1	Has	5 682

Rrethi i Hasit shtrihet ne Veri-Lindje te Shqiperise dhe ne kufi me Kosoven.
Ndodhet ne nje lartesi prej 370-450m mbi nivelin e detit.

Brenda territorit të vendit kufizohet me Qarkun e Kukesit dhe Rrethin e Tropojes.

Rrethi i Hasit ka një sipërfaqe pyjore prej **23775.3** ha ku:

LLOJET KRYESORE TË DRURËVE

	Emërtimi	Sip/Ha	Vëllimi 000/m³
a	**Halorë**		
1	Pishë e zezë		
2	Bredh		
3	Halorë të tjerë		
b	**Fletorë**		
1	Ah	2206.5	**400234.3**
2	Lis	17520.3	**337462.9**
3	Plep	2.5	**181**
	Fletorë të tjerë	2706.8	**108785.5**
c	**Shkurre**		
1	Mare		
2	Shkozë		
3	Të tjera	1339.2	**1634.5**
	GJITHSEJ	**23775.3**	**848298.2**

VLERËSIMET E RREZIQEVE TË MUNDSHME NGA ZJARRET NË PYJE

Nr	Bashkia	Sipërfaqja Totale ha	Vëllimi m 3	Pyje prodhuese ha	Vëllimi m3	Pyje mbrojtëse ha	Vëllim m3
1	Has	23775.3	848298.2	16654.61		7120.7	

Gjatë dekadës së fundit fundit zjarret në pyje në Rrethin e Hasit kanë filluar të ulen si numër, për pasojë është ulur dhe përmasa e sipërfaqeve të prekura.

Shkaqet kryesore të zjarreve janë pakujdesia e njerëzve, djegia për kullota dhe natyrore (rrufetë), por gjatë viteve të fundit janë shtuar rastet e zjarreve të qëllimshme.

Shumica e dëmeve të shkaktuara kanë ndodhur në pyjet halore.

Pjesa më e madhe e popullsisë së Rrethit të Hasit jeton në zona rurale dhe varet kryesisht prej veprimtarisë të bujqësisë ekstensive dhe blektorisë.
Keqpërdorimi i pyjeve nga njerëzit (i shoqëruar me shpyllëzimet gjatë viteve të kaluara) dhe praktikat e kullotjes, pa dyshim janë shkaktarët e pjesës më të madhe të shkatërrimit të pyjeve.

Kullotat e pakufizuara dhe zjarret e pakontrolluara, të shkaktuara aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllime pastrimi kullotash, vijojnë të ndodhin në vend.
Dëmet e korijeve, të shkurreve e të kullotave dhe humbjet e lidhura me to janë dëme të fushës mjedisore.

Shkalla e këtyre humbjeve kërkon vëmendjen e gjithë subjekteve të interesuara, duke përfshirë edhe Shërbimet e Mbrojtjes Civile.

III.INVENTARI I BURIMEVE PËRKATËSE.

Për përballimin e kësaj fatkeqësie, do të bazohemi kryesisht në strukturën shtetërore.

Burime llogjistike për përballimin e zjarreve në pyje:
Të gjitha burimet llogjistike do të nxirren e përballohen nga Bashkia Has.

Sipas akteve ligjore në kuadër të ndryshimeve të qeverisjes vendore strukturat që do të marrin pjesë në përballimin e zjarreve aktualisht janë të vendosura në Bashki.

Materialet që do të jenë në përgjigje të emergjencës së zjarreve janë:
Bashkia ka në dispozicion 2 automjete zjarrfikës.
Mjete pune: Sopata 2, kumesa 4, lopata 7, motosharrë 1, 20 fikse me ujë, kazma 2, sëpata 1, fresibël l, motorsekë 1.

Në dispozicion të situatave për zjarret në pyje vihen një personel prej 10 vetash nga personeli zjarrfikës.
Nga institucionet e tjera kryesisht për transport vihen në dispozicion 3 mjete.

NË BASHKINË HAS ËSHTË KJO STRUKTURË SHËNDETËSORE E CILA DO TË SHËRBEJË PËR RASTET E SITUATAVE EMERGJENTË VERORE

Nr	EMËRTIMI OBJEKTIT SHËNDETSOR	HASI	
		Sasia	Kapaciteti shtretër
1	Spitali Civil	1	34
2	Spitali Efektiv		
3	Spital Obsetrik Gjinekologjik		
4	Qendra Shëndetësore.	5	

Personeli mjekësor nuk është i specializuar për Spitalin Has, për të bërë ndërhyrje kirurgjikale.

Furnizimi me ujë të pijshëm

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm kryhet nga:
Sh.A Ujësjellësi Has për rrethin e Hasit.
Ujësjellësi i rrethit të Hasit e bën furnizimin me ujë të popullatës me ngritje mekanike.

Ky institucion ka në dispozicion:

Nr.	EMËRTIMI	HAS
1	Iveko	1

Kanë mungesa ne gjendje materiale të pjesshme për ndërhyrje emergjente si tuba, gjenerator dhe pompë.

Energjia elektrike:
Furnizimi me energji elektrike në Rrethin e Hasit bëhet nga:
Agjensitë e Elektrikut Has.
Kjo agjensi ka në dispozicion:

Nr.	EMËRTIMI	SASIA (copë)
1	Furisdrada	3
2	Autovinç	1
3	Kamioçinë	1

IV.SKENARI PËR QËLLIM PLANIFIKIMI

Nga data 28 Qershor dhe në vazhdim Rrethi i Hasit përfshihet nga kushte klimaterike me temperatura të larta që variojnë nga 35-40 gradë Celsius.
Pasojë e këtyre temperatur mund të kemi shfaqje të zjarrëve në pyje në shkallë Rrethi e sidomos më masivet pyjore të Njesive Administrative Golaj dhe Fajza.

Erërat në drejtim të Jugut kanë dhënë impuls të mëtejshëm përhapjes së zjarreve në të gjithë masivet pyjore.

TERITORET E BANUARA TË RREZIKUARA NGA ZJARRET RRETHI HAS

Teritoret e banuara të rrezikuara (jeta e popullsisë e objekteve të banimit) sipas fshatrave, Nj.Adm, bashkive nga zjarret në pyje e kullota:

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	FSHATI
1	Bashkia Qendër	Cahan
		Mujaj
2	Golaj	Helshan
		Kostur
		Peraj
		Qarr
		Dobrunë
3	Gjinaj	Pus i Thatë
		Pogaj
4	Fajza	Tregtan
		Sefoll

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

V. ORGANIZIMI PËRGJEGJËSITË DHE BASHKËPUNIMI:

Strukturat që do të përfshihen në kushtet e emergjencës do të jenë:
Bashkia Has

Sektori i Ekstencionit Bujqësor
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
Drejtoria Vendore e Kufirit e Migracionit
Komisariati i Policise Has
Drejtoria Rajonale e Mjedisit
Administrata e Zonave të Mbrojtjes
SH.A Ujësjellësi Has,
Kryqi i Kuq dega Has.

Biznesi Privat

Komuniteti

Puna që do të bëjnë:

Duke u ballafaquar me këtë problem kaq të mprehtë tashmë ekziston një strategji e mbrojtjes së pyjeve e cila kërkon kontributin e të gjithë strukturave, për tu bërë efektive dhe për të arritur rezultatet e pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare siç janë pyjet.
Masat për menaxhimin e zjarreve që duhet të perforcohen nga këto struktura janë:

DETYRAT E BASHKISË:

-Ringritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile me strukturat që janë në Juridiksionin Tuaj.

-Marrja pjesë e përfaqësuesve të Njesive Administrative në mënyrë aktive në aktivitetin e grupeve të KMC-së të Bashkise dhe raportojnë në mënyrë periodike pranë Kryetarit të Bashkisë.

-Të përgatisë Planet e Mbrojtjes Civile të bashkisë e të informojë Prefektin e Qarkut për nivelin e përgatitjes, problemet e dala e kërkesat e domosdoshme.

-Të freskojë Planet e Gadishmërisë në nivel njësie vendore, për përballimin e emergjencave verore dhe ti raportoje ato pranë Prefektit të Qarkut.

-Realizimi i Akt-Marrëveshjeve për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

-Analizimin e gjendjes së kapaciteteve njerëzore, të mjeteve e të teknikës që kanë në dispozicion dhe masat që duhen të merren për parandalimin dhe përballimin e situatave që mund të krijohen gjatë stinës së verës.

-Venien në gadishmëri për ndërhyrje në rast nevoje, të kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore si strukturave të shërbimit të MZSH-ve, të ndërmarrjeve që ato kanë në varësi si UKT sha etj, me qëllim furnizimin e popullatës në ato raste kur mungon uji i pijshëm.

-Evidentimin nga kryetarët e njësive administrative të fermerëve që kanë plantacione frutikulturë, për rritjen e kujdesit të veçantë për to.

-Evidentimin e blegtorëve dhe zonat e patronazhit në pyje e kullota, për tërheqjen e vëmendjes dhe kujdesin për parandalimin e zjarreve.

-Të evidentoj nevojat dhe të ofrojë ndihmën për banorët në çdo rast për përmbushjen e nevojave jetike.

-Të evidentojë zonat e rrezikuara nga zjarret gjatë stinës së verës.

-Të organizojë punën konkrete për shuarjen e zjarreve nëpërmjet Shërbimit Pyjor, M.Z.SH-së që janë në varësi të Bashkisë, në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave e grupe vullnetarësh të trajnuar në këtë drejtim.

-Krijimin e brezave pyjor, për pengimin e përhapjes së zjarreve.

-Krijimin e bazeneve apo rezervuareve të ujit për fikjen e zjarreve.

-Organizimin e punës për gjetjen e rrugëve të mundshme për lëvizjen e mjete të shuarjes së zjarreve.

-Të organizojë sistemin e lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit.

-Të ndërtohet sistem lajmërimi efikas ndërmjet inspektoriatit, drejtuesit të organit vendor, kryetarët e fshatrave, strukturave policore e institucionin e Prefektit për rajonin ku ka rënë zjarri në pyje.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

-Të merren masa dhe të bashkëpunohet me Strukturat e Policisë së Shtetit për parandalimin e problematikave të trashëguara ndër vite të zjarrëvënieve të qëllimshme të pyjeve dhe kullotave.

-Stërvitje specifike me strukturat e MZSH-së e aktorët që marrin pjesë në përballimin e situatave të sezonit veror, për ndërhyrje në situata të veçanta të zjarreve.

-Organizimin e bashkëveprimit me strukturën operacionale për shuarjen e zjarreve në pyje e kullota.

-Rritjen e bashkëpunimit me institucionet e strukturat, për sensibilizimin e komunitetit në zonat rurale, turistike, të fermerëve, blegtorëve, nxënësve nëpërmjet përdorimit të mediave lokale, fletëpalosjeve etj, për t'u përgatitur për stinën e nxehtë të verës dhe për reagimin e të gjithëve ndaj emergjencave verore me pasoja për jetën njerezore, pasurinë, trashëgimninë kulturore dhe mjedisin.

-I propozohet Kryetarit te Bashkise për përcaktimin e vendfurnizimeve me ujë të mjeteve ajrore që mund të përdoren për shuarjen e zjarreve.

-Standartizimi i skemave të informimit dhe mënyrën e komunikimit nga ana e Komisionit të MC-së të Bashkisë, të strukturave të MZSH-së, Policisë së Shtetit, shërbimit pyjor për të përcjellë në kohë reale informacionin për çdo ngjarje, duke njoftuar Komisionin e MC-së në shkallë Qarku nga ku përcillen në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, për koordinimin e mjeteve tokësore, ajrore dhe forcave operacionale për ndërhyrjen në kohë me qëllim eleminimin sa më të shpejtë të incidenteve dhe zjarreve të mundshme në pyje, kullota, në zonat rurale, urbane, turistike, industriale etj.

-Është i domosdoshëm bashkëpunimi për dhënie informacioni, i cili të jetë në mënyrë sa më të shpejtë e të saktë me Komisionin e MC-së Bashkisë, më qëllim ndërhyrjen sa më efikase në terren, për shmangien e fatkeqësive.

KOMISARIATI I POLICISË

-Të mundësojë mbështetjen për ndërhyrjen në zonat e rrezikuara me mjete shpëtimi dhe mjete me kalueshmëri të lartë dhe ti vendos në dispozicion të KMC-së Bashkisë.

-Të dislokoje njësitë e forcave për evakuimin e personave të rrezikuar nga zjarret.

-Të bashkëpunojë me Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave e strukturat e tjera shtetërore për goditjen e paralizimin e veprimtarisë keqbërëse për zjarret në pyje.

-Me strukturat e specializuara të goditet elementi keqbërës të cilët stimulojnë apo nxisin zjarret në pyje.

DMR

-Të vendos në dispozicion të fazës së përgjigjjes ndaj zjarreve burimet njerëzore dhe logjistikën e nevojshme (mjete me kalueshmëri të lartë, zjarrëfikëse etj) pjesë e inventarit të saj.

-Të angazhohet në mënyrë të pandërprerë për operacionet e shpëtimit apo evakuimet e mundshme.

DREJTORIA VENDORE E POLICISË KUFIRIT E MIGRACIONIT

-Të vendos në dispozicion të fazës së përgjigjes ndaj zjarreve burimet njerëzore dhe logjistikën e nevojshme pjesë e inventarit të saj.

-Të angazhohet në mënyrë të pandërprerë për operacionet e shpëtimit apo evakuimet e mundshme.

-Të bashkëpunojë me strukturat e tjera për ndërhyrje kryesisht në kullotat e lartësive ku mund të kenë dislokim forcash.

NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR

- Ndjekjen me përparësi të shëndetit të popullatës e sidomos të marrjes së masave për përballimin e sëmundjeve infektive që mund të prekin popullatën.
- Të mbahet në gadishmëri të plotë reparti i urgjencës me llogjistikën e nevojshme.
- Të mbajë në gadishmëri krevate, për përballimin e situatave të mundshme shëndetësore të krijuara si pasojë e zjarreve.

SEKTORI I EKSTENCIONIT BUJQËSOR

- Përpilimin e planizimit për veprimtaritë që do të kryhen në organizimin e masave për përballimin e fatkeqësive që mund të ndodhin nga temperaturat e larta.
- Rritjen e bashkëpunimit me institucionet e strukturat për sensibilizimin e komunitetit në zonat rurale, turistike, të fermerëve, blegtorëve, nxënësve nëpërmjet përdorimit të mediave lokale, fletëpalosjeve etj, për t'u përgatitur për

stinën e nxehtë të verës dhe për reagimin e të gjithëve ndaj emergjencave verore me pasoja për jetën njerëzore, pasurinë, trashëgimninë kulturore dhe mjedisin.

- Evidentimin nga kryetarët e njësive administrative të fermerëve që kanë plantacione frutikulturë, për rritjen e kujdesit të veçantë për to.

- Evedentimin e blegtorëve dhe zonat e patronazhit në pyje e kullota, për tërheqjen e vëmendjes dhe kujdesin për parandalimin e zjarreve

SH.A. UJËSJELLËS

- Të mbajë në gadishmëri hidrantet për furnizimin e mjeteve zjarrfikëse, linjat për furnizim me ujë të pijshëm të popullatës së prekur nga fatkeqësia duke ndërhyre me grupet e gadishmërisë për eleminimin e emergjencave në këtë shërbim publik.

OSHEE-SË HAS

- Do të mbajë në gadishmëri rrjetin e furnizimit me energji të popullatës e marrjen e masave për eleminimin e avarive që mund të ndodhin.

KRYQI I KUQ DEGA HAS

- Si partner kryesor do të bashkërendojë me Komisionin KMC-në në shkallë Bashkie për të ndërhyre në veprimtari humanitare.
- Rezervat e Shtetit: Bëjnë programin e punës për krijimin e shpërndarjen e rezervave në zonat e prekura nga fatkeqësitë.
- Biznesi privat: Do të punojë për krijimin e rezervave logjistikë në përballimin e fatkeqësive.

- Të gjithë strukturat do të bashkëpunojnë për sensibilizimin e komunitetit në zonat rurale, turistike, të fermerëve, blegtorëve, nxënësve nëpërmjet përdorimit të mediave lokale, fletëpalosjeve etj, për t'u përgatitur për stinën e nxehtë të verës dhe për reagimin e të gjithëve ndaj emergjencave verore me pasoja për jetën njerezore, pasurinë e trashëgiminë kulturore.

VI. PËR BASHKËPUNIMIN ME BASHKITË FQINJE

- Organizimi i bashkëveprimit ndërmjet Bashkive realizohet kryesisht me Bashkine e Tropojes, qarkun e Kukesit dhe pjesën e komunës se Gjakoves që janë përgjatë

kufirit shtetëror për veprime të përbashkëta e ndihmë të ndërsjellta në shuarjen e zjarrit.

- Bashkëveprimi në Bashkine e Tropojës do të jetë në këto drejtime:
  Për shuarjen e zjarrëve të përbashketa

- Me Bashkinë e Kukesit realizohet bashkëveprimi në këto drejtime:
  Për shuarjen e zjarreve të përbashkëta.

- Për komunat Golaj do të realizohet bashkëveprimi me komunën e Gjakovës për dërgimin e të semurëve të fshatrave kufitare në Gjakovë.
- Bashkëveprimi do të jetë me të gjithë fqinjët për dhënie e marrje informacioni reciprok.

ANËTARËT E KOMISIONIT TË MBROJTJES CIVILE TË BASHKISË.

KRYETARI
Miftar Dauti
0692125774
miftar.dauti@bashkiahas.gov.al

Zv.NËNKRYETAR/E
Zenel Sheta
0686075111
zenel.sheta@bashkiahas.gov.al
Shyrete Koka
0694141398
shyrete.koka@bashkiahas.gov.al

DREJTORESHA E MBROJTJES CIVILE
Arbërie Rada
0697948122
arbërie.rada@bashkiahas.gov.al

PËRGJEGJËSI I E.CIVILE
Fatos Ahmati
0692778300
tosi.777@hotmail.com

1-Kryetari i Nj.Adm. Golaj
Artjola Brati
0697948061
2-Kryetari i Nj.Adm. Fajza
Sadik Dajçi
0692682631
3-Kryetari i Nj.Adm. Gjinaj
Pellumb Thaçi
0684046577
4-Inspektor i Policise Bashkiake
Fadil Muja
0698926898
5-Shefi i Komisariatit Has
Astrit Përlesha
0694111868
6-Pergj.St.MZSH Has.
Jetmir Lala
0694111274
7-Pergj.Bordit te Kullimit
Islam Lisha 0692568268
8-Pergj.Sekt.Rrugeve Rurale/komanduar
Arsen Rrushi 0686265800
9-Drejtor Sek.Sherbimëve Publike
Bledar Lushi
0692645339
10-Drejtor i Sek. Pyjor.
Fadil Dauti
0693561445
11-Drejtor SHA Ujësjellesi
Ferit Mazrreku
0693914111
12-Drejtor i Spitalit Has.
Shaban Peka
0697394188
13 Drejtor i Arsimit, Kultures, Rinise dhe Sportit
Imer Dauti 0698888353
14-Përgjegjëse e sektorit Juridike
Erisa Ferizolli
0686574445
15-Pergj.Sektorit te Urbanistikes.
Novruz Bardhoshi
0686265800
16-Drejtor i Sek. Finances.
Sahit Meshi 06982095147
17-Përfaqësues i Kryqit të Kuq.
Kujtim Derri 0692233822
18- Përgjegjëse e OSHEE
Din Poga 0695719004
19-Drejtor Shëndetit Publik
Arjana Ukperaj 695144958
20- Përgjegjëse Sek. Arsimit.Kultures.
Flutura Aliaj
0693561270
21-Përgj Taksave Dritan Qerkezi
0683189323

NGA ADMINSTRATA E BASHKISE DO TË KRIJOHEN GRUPET E PUNËS:

Grupi i Informacionit

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	Arbërie Rada	Drejtoresha e Mbrojtjes Civile
2	Fatos Ahmati	Përgjegjës i Emergjencave Civile
3	Fadil Dauti	Drejtor i Sektorit Pyjor
4	Erisa Ferizolli	Përgjegjës i Sektorit Juridik
5	Islam Lisha	Përgjegjës i Bordi i Kullimit
6	Arsen Rrushi	Pergjegjës i Sektorit Rrugeve Rurale/Komanduar
7	Jetmir Lala	Pergjegjës i Sektorit MZSH Has

Grupi i Vleresimit:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	Novruz Bardhoshi	Pergjegjës i Sektorit Urbanistikes
2	Sahit Meshi	Drejtor i Finances
3	Fatos Ahmati	Përgjegjës i Emergjencave Civile

Grupi i ndjekjes së shpërndarjes së ndihmave:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	Arbërie Rada	Drejtoresha e Mbrojtjes Civile
2	Sahit Meshi	Drejtor i Sektorit Financës
3	Erisa Ferizolli	Përgjegjës i Sektorit Juridik

Grupi i marëdhënieve me MEDIAN:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni
1	Zenel Sheta	Zv/Kryetar i Bashkise
2	Arbërie Rada	Drejtoresha e Mbrojtjes Civile
3	Erisa Ferizolli	Përgjegjës i Sektorit Juridik
4	Fatos Ahmati	Përgjegjës i Emergjencave Civile

Nga Bashkia do të krijohet e funksionojë Komisioni i M.C-së.
Komisioni do të mblidhet cdo ditë në ora 16.00.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

MASAT PËR PARANDALIMIN

Fenomenet që mund të shkaktojnë emergjenca të zjarreve në Rrethin e Hasit janë temperaturat e larta e veprimtaria keqbërëse njerëzore.
Vëzhgimi do të bëhet nga kryetarët e fshatrave e personeli i gadishmërisë së institucioneve.

Paralajmërimi i hershëm bëhet nga shërbimi sinoptik i vendosur në Meteor Kukës.
Nga Qendra Sinoptike do të bëhet njoftimi i Kryetarit e Zv. Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile.

VII. KOMUNIKIMET

Mënyra e komunikimit midis niveleve të ndryshme do të bëhet me mobile e telefon kabllor. Do të shfrytëzohen ndërlidhja me radio nga Komisariati i Policisë.
Komunikimi me media do të bëhet nga komunikatat e shtypit të zëdhënësit të komisionit si dhe të konferencave të shtypit të organizuara nga kryetari apo zv.kryetarët e komisioneve.

VIII. EVAKUIMI DHE SHPËTIMI

Në rastet e krijimit të fatkeqësisë nga zjarret e cila shoqërohet me pasoja në objekte e njerëz do të veprohet nga kjo strukturë operacionale:

DREJTUES I OPERACIONIT:

MZSH
Komisariati i Policise
Shërbimi i Ambulancës
Kryqi i Kuq

IX. EMERGJENCA SHËNDETËSORE

Njësia Vendore e Shëndetit Publik do të përballojnë nëpërmjet infrastrukturës së këtij shërbimi, dhe do të veprojë reparti i Urgjencës Spitalore Has.
Ndërhyrjet e specializuara kirurgjikale do të bëhen në repartet kirurgjikale të spitaleve civile Kukës dhe Gjakovë.
Nga spitalet do të mbahen grupet e urgjencës së gatshme për ndërhyrje.

X.PUNIMET URGJENTE PËR RIPARIMIN E MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE

Punimet urgjente për mirëmbajtjen e infrastrukturës publike.
Ndërhyrjet me emergjente që kërkohen:
Sistemimi e rehabilitimi i rrugëve nacionale të cilat do të nevojiten për ndërhyrje.

Krumë-Gjinaj-Domaj-Pogaj.
Krumë -Cahan-Kishaj.

XI. DËRGIMI DHE SHPËRNDARJA E NDIHMAVE

Magazinimi:
Magazinimi i mallrave do të bëhet kryesisht te magazinat e bashkisë, tek ish gjimnazi i vjetër.
Nga biznesi privat mbahen në magazinat e tyre.
Artikujt ushqimore e jo ushqimore do të grumbullohen në të njëjtat magazina.

Shpërndarja:
Shpërndarja e artikujve ushqimore e jo ushqimore do të bëhet nën drejtimin e grupit të shpërndarjes së ndihmave.
Shpërndarja do të bëhet nga Bashkia. Nga Bashkia do të bëhet shpërndarja e drejtpërdrejtë në Nj.Administrative e nga kjo në fshatra nëpërmjet kryetarëve të fshatrave.

Vëzhgimi:
Do të bëhet nga anëtaret e komisionit të bashkive.
Për çdo dërgesë do të ketë përfaqëues të bashkisë.

Raportimi:
Raportimi do të bëhet nga Kryetarët e Njësive.
Për problemet e dala njoftohet menjëhere kryetari i Komisionit MC-së të Bashkisë.

XII. VENDET E PËRKOSHME TË STREHIMIT

Konvikti i shkolles se mesme Krumë. Hoteleritë në qytete dhe disa shkolla në fshatra.
Shtëpitë e braktisura si rezultat i lëvizjes së popullsisë në drejtim të qendrave urbane.

XIII. SHËNDETI PUBLIK

Do të jetë në vëmendje të gjithë institucioneve që lidhen me këto shërbime.

Uji i pijshëm do të jetë nën mbikqyrjen e vazhdueshme të epidemiologëve dhe punonjësve të ujësjellësave.
Higjena publike do të ndiqet nga Shëndeti Pubik duke ndjekur gjatë gjithë kohës gjendjen e shëndetit të popullatës.

XIV. RUAJTJA E RENDIT PUBLIK E QETËSISË PUBLIKE

Nga Komisariati i Policisë në zbatim të akteve ligjore me Programe të Veçanta, do të mbajnë rendin e qetësinë publike. Gjatë gjithë kohës do të bashkëveprohet me Kryetarin e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Bashkise, për problemet e dala duke shoqëruar me masat për eleminimin e tyre.
Në qytete do të veprojnë forcat e specializuara të gadishmërisë.
Në Njesitë Administrative Inspektorët e zonave, Policia Bashkiake.
Në rastet e fatkeqësisë nga Komisariati i Policise do të bëhet izolimi i zonës e marrjen pjesë drejtëpërsëdrejti në operacionet e kërkim shpëtimit.

XV.NEVOJAT PËR BAZË MATERIALE KOSTOJA DHE PREVENTIVI

Për përballimin e emergjencave civile që mund të krijohen si pasojë e temperaturave të larta në Rrethin e Hasit janë këto nevoja.

- Bashkia Has duhet të mbajnë fondin e domosdoshëm financiar.
- Bazë llogjistike e shërbimit pyjor të vendosura në bashki për emergjencën civile gjatë periudhës verore.
- Bashkia është e domosdoshme të bëjnë planizim të plotë të shoqëruara me kapacitetet që kanë e kërkesat e domosdoshme.
- Bashkia të bëjë shfrytëzimin e të gjitha resurseve vendore në interes të situatave.
- Strukturat operacionale të planizojnë kryerjen e stërvitjeve me qëllim përballimin e situatave që krijohen nga temperaturat e larta.

XVI.Ky Plan Gadishmërie gjatë gjithë kohës do të rishikohet e përpunohet në përshtatje me zhvillimin e fenomeneve të fatkeqësive e emergjencave civile sezonale verore.

PËRGJEGJËS I EMERGJENCAVE CIVILE

FATOS AHMATI

DREJTORESHA E MBROJTJES CIVILE

ARBËRIE RADA

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al